



Përditësim për shtypin

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në gjykimin e Hashim Thaçit, Bashkim Smakajt, Isni Kilajt, Fadil Fazliut dhe Hajredin Kuçit, më 9 qershor, Gjykatësi i Vetëm bëri konstatim gjyqësor të një sërë fakteve për të cilat palët janë në pajtim, të cilat u dorëzuan nga Prokuroria. Duke pasur parasysh parimin e procesit publik, Gjykatësi i Vetëm urdhëroi Prokurorinë të dorëzonte versionet e redaktuara publike të disa parashtrimeve dhe udhëzoi Zyrën Administrative të riklasifikonte disa parashtrime të tjera si publike. Riklasifikimi tashmë ka përfunduar.

Në gjykimin e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, më 8 qershor, Trupi Gjykues miratoi kërkesën e një viktime pjesëmarrëse për ndryshim të pjesshëm të masave mbrojtëse. Ai konstatoi se rrethanat personale të viktimës përbënin arsye bindëse për t'i ndryshuar masat.

Më 10 qershor, Trupi Gjykues urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të Hashim Thaçit, me konstatimin se ende ekzistojnë rreziqe që, në qoftë se lirohet, z. Thaçi do të pengojë ecurinë e procesit dhe do të kryejë vepra penale të tjera, përfshirë kundër dëshmitarëve që kanë dhënë dëshmi në çështjen gjyqësore.

Gjykatësi i Vetëm rikujtoi se z. Thaçi ka interesin dhe mundësinë për të ndërhyrë në proces dhe se pretendohet që ai u dha vizitorëve jo të privilegjuar informacion të marrë gjatë dhënies së dëshmimeve prej dëshmitarëve të mbrojtur, si edhe se diskutoi udhëzime për t'iu përcjellë dëshmitarëve lidhur me përmbajtjen e dëshmimeve të tyre. Sipas Gjykatësit të Vetëm, lirimi i z. Thaçi, kur ai ka në zotërim informacion të ndjeshëm, do të dëmtojë mbrojtjen efektive të dëshmitarëve.

Trupi Gjykues theksoi se këto rreziqe ekzistojnë në atmosferën e përgjithshme të frikësimit të dëshmitarëve në Kosovë dhe nuk mund të kapërcehen vetëm me masa mbrojtëse, dhe arriti në përfundimin se vetëm në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara është e mundur që komunikimet e z. Thaçi të kufizohen në një mënyrë që zvogëlon mjaftueshëm rreziqet e evidentuara.

Në çështjen e Pjetër Shalës, më 5 qershor, Paneli i Gjykatës Kushtetuese vendosi që gjuha e punës në procesin e shqyrtimit të kërkesës referuese të z. Shala në lidhje me Urdhrin për Zhdëmtime do të jetë anglishtja. Zyra Administrative do të mundësojë përkthimet zyrtare me shkrim dhe me gojë në shqipë dhe serbisht.

Gjykata Kushtetuese udhëzoi Prokurorinë që t'i përgjigjet kërkesës referuese deri më 15 qershor dhe z. Shala të kundërpërgjigjet ndaj përgjigjes së Prokurorisë deri më 10 korrik. Paneli udhëzoi më tej palët të dorëzojnë versionet e redaktuara publike të parashtrimeve të mëparshme të tyre ose të kërkojnë që ato të riklasifikohen si publike, gjë që palët e bënë. Paneli u kërkoi gjithashtu palëve që në të ardhmen t'i dorëzojnë parashtrimet si publike ose të parashtrorjnë versione të redaktuara publike të tyre.





Dhomat e Specializuara kanë filluar të postojnë një sërë videomaterialesh shpjeguese në faqen e internetit dhe në kanalet e rrjeteve sociale me informacion të saktë dhe të dorës së parë mbi mandatin, proceset dhe aktivitetet e tyre. Videomaterialet, që i drejtohen veçanërisht publikut në Kosovë, trajtojnë disa nocione të pasakta që hasen zakonisht dhe synojnë të mundësojnë një të kuptuar më të mirë të punës së Gjykatës.

